



**Më shumë
Zgjedhje** përmes
Politikave Miqësore për Familjen



Financuar nga
 Austrian
Development
Cooperation

ANALIZË E POLITIKAVE TË PËRGJEGJSHME GJINORE PËR FAMILJEN NË SHQIPËRI

RREGULLIMET E LEJEVE TË LINDJES

Në Shqipëri, prindërit kanë të drejtë të marrin leje lindje për nënën, për babain, leje prindërore, dhe leje për përkujdesje ndaj fëmijës.

LEJA PRINDËRORE

Leja Prindërore është një koncept i prezantuar në ndryshimet ligjore të Kodit të Punës në 2015. Leja prindërore është katër muaj derisa fëmija të mbushë moshën gjashtë vjeç dhe mund të merret e ndarë, por jo më pak se një javë në vit. Secili nga prindërit mund ta kërkojë lejen prindërore individualisht. Kjo leje është e papaguar dhe nuk mund të transferohet nga njëri prind tek tjetri. I njëjti rregull ndiqet dhe për fëmijën e birësuar.



LEJA E LINDJES PËR NËNËN

Nëna përfiton 365 ditë kalendarike leje lindje me një minimum prej 35 ditësh përpara dhe 63 ditë pas ditës së lindjes. Për gruan shtatzanë me më shumë se një fëmijë, periudha e përfitimit është 390 ditë duke përfshirë minimumin e 60 ditëve përpara dhe 63 ditë pas lindjes.



Në rastin e birësimit për një fëmijë deri një vjeç, leja e lindjes është 330 ditë dhe fillon ditën e birësimit me një minimum prej 28 ditësh.

Leja e lindjes paguhet për 35 ditë para ditës së lindjes dhe për 150 ditë kalendarike pas lindjes, me 80 përqind të mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të dymbëdhjetë muajve të fundit. Pjesa e mbetur e 180 ditëve paguhen me 50 përqind. Të ardhurat e lejes së lindjes përfitohen vetëm nëse gruaja ka derdhur kontribute për të paktën 12 muaj. Ky kusht duhet të plotësohet për çdo fëmijë, me përjashtim të rastit kur shtatëzania e radhës ndodh brenda 24 muajve nga data e lindjes së fëmijës së mëparshëm.

LEJA E LINDJES PËR BABAIN

Kodi i Punës i lejon baballarët të marrin tre ditë leje nga dita e lindjes së fëmijës, të cilat duhen paguar nga punëdhënësi. Baballarët mund të marrin lejen e lindjes pas 63 ditësh kur përfundon periudha e detyrueshme e lejes së lindjes për nënën. Ky rregull zbatohet edhe për babain birësues.

Leja e lindjes për babait është 267 ditë kalendarike. Nëse nëna nuk përfiton leje lindje babai i siguruar për 12 muaj paguhet 150 ditët e para me 80 përqind të mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të dymbëdhjetë muajve të fundit. Pjesa tjetër e mbetur e ditëve të lejes paguhet me 50 përqind. Të ardhurat për lejen e lindjes së babait mbulohen financiarisht nga Skema e Sigurimeve Shoqërore.



LEJA E PËRKUJDESJES NDAJ FËMIJËS



Sipas rregullimeve të Kodit të Punës, në rast përkujdesjesh të domosdoshme për fëmijët në ngarkim, prindërit kanë të drejtën e 12 ditë leje të paguar në vit. Prindërit me fëmijë deri në tre vjeç, kanë të drejtë për një leje të paguar deri në 15 ditë, kur fëmija është i sëmurë, vërtetuar me raport mjekësor. Prindërit kanë të drejtën e një leje shtesë jo më shumë se 30 ditë në vit pa pagesë. Leja i jepet prindit që kujdeset për fëmijën. Në rast të kundërt leja alternohet mes nënës dhe babait.

RREGULLIMET FINANCIARE

PËRFITIMI FINANCIAR I LEJEVE

Mbështetja financiare për lejet e lindjes për nënën dhe babain bëhen nga Skema e Sigurimeve Shoqërore të përkrahura si më sipër. Nuk ka rregullime të tjera ligjore që mbështesin financiarisht prindërit apo fëmijët.



SHPËRBLIMI PËR LINDJEN E FËMIJËS



Mbështetur në Ligjin për Sigurimet Shoqërore, shpërblimi për lindjen e fëmijës paguhet vetëm njëherë. Kusht është që nëna ose babai të kenë qenë të siguruar të paktën për një vit para datës së lindjes. Prioritet në përfitimin e shpërblimit ka nëna. Shpërblimi është i barabartë me 50 përqind të pagës minimale për çdo fëmijë të lindur ose ndryshe 13.000 Lek.

USHQYERJA E FËMIJËS ME GJI

Rregullimet e Kodit të Punës i japin të drejtën nënës me fëmijë në gji, që të zgjedhë midis një pushimi të paguar prej dy orësh në orarin normal të punës ose një orari pune të shkurtuar me dy orë me të njëjtën pagë si orari normal. Ky lloj përfitimi është i vlefshëm nëse nëna vendos të kthehet në punë pas periudhës 63 ditë pas lindjes deri sa fëmija të mbushë një vjeç.



PËRKUJDESJA NDAJ FËMIJËS



Përveç lejeve të paguara për përkujdesjen ndaj fëmijës, të përkrahura më sipër, nuk ka rregullime të tjera financiare që mbështesin prindërit.

Ligji i Sigurimeve Shoqërore lejon për prindërit me aftësi të kufizuara, të përfitojnë një shtesë prej pesë përqind të bazës së pensionit për t'u kujdesur për fëmijët e tyre. Përfitimi shtesë prej pesë përqind është për secilin fëmijë derisa fëmija të bëhet 18 vjeç por jo më i madh se 25 vjeç nëse fëmija studion dhe nuk është në gjendje të punojë. Në total, përfitimi financiar për kujdesin ndaj fëmijëve nuk mund të kalojë 30 përqind të pensionit bazë për aftësinë e kufizuar.


AKSESI PËR PËRKUJDESJEN NDAJ FËMIJËS

Nuk ka rregullime të veçanta përsa i përket aksesit për përkujdesje ndaj fëmijës për prindërit në marrëdhënie pune. Sistemi i përkujdesjes ndaj fëmijës (kopshtet dhe çerdhet) janë nën drejtimin e Njësive të Vetqeverisjes Vendore. Këto institucione janë të shpërndara si në zonat urbane ashtu dhe në ato rurale dhe mbledhja e të dhënave mbetet një sfidë. Vlera e tarifës për kopshtet dhe çerdhet është e ndryshme pasi vendoset me vendim të Këshillit Bashkiak për secilën bashki.



RREGULLIMET PËR PUNËN

GRATË SHTATZËNA DHE NËNAT E REJA



Kodi i Punës rregullon kushtet e punës për gratë shtatzëna dhe nënat e reja. Rregullat janë të zbatueshme njësoj si për sektorin publik ashtu dhe për sektorin privat.

Është e ndaluar kryerja e orëve shtesë të punës nga gratë shtatzëna dhe pas lindjes së fëmijës, derisa fëmija të mbushë moshën një vjeç. Gratë shtatzëna janë të ndaluara të punojnë 35 ditë para lindjes (ose 60 ditë kur shtatzëna ka më shumë se një fëmijë) dhe 63 ditë pas lindjes. Gratë shtatzëna ose me fëmijë në gji nuk mund të punësohen në punë të rënda ose të rrezikshme që dëmtojnë shëndetin e nënës

dhe të fëmijës.

Në përfundim të 63 ditëve të paslindjes, gruaja vendos vetë nëse dëshiron të punojë ose të përfitojë nga sigurimet shoqërore. Kur gruaja vendos të rikthehet, por vendi i mëparshëm i punës nuk plotëson kushtet për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit në punë, punëdhënësi merr masat e nevojshme për të siguruar përshtatjen e përkohshme të kushteve të punës dhe të orëve të punës.

MBROJTJA E VENDIT TË PUNËS DHE E KONTRATËS


Mbrojtja e vendit të punës dhe zgjidhjes së kontratës gjatë përfitimit të lejes së lindjes për nënën dhe babain, rregullohet nga Kodi i Punës. Rregullat janë të zbatueshme njësoj si për sektorin publik ashtu dhe atë privat.

Me mbarimin e lejes së lindjes, punëmarrësi ka të drejtë të kthehet në vendin e punës ose në një vend pune të barasvlershëm, në kushte njësoj të favorshme. I njëjti rregull zbatohet dhe në rastin e birësimit.

Është e pavlefshme zgjidhja e kontratës së punës e njoftuar nga punëdhënësi në periudhën gjatë së cilës punëmarrësi ka përfituar lejen e lindjes për nënën ose babain. I njëjti rregull zbatohet dhe në rastin e birësimit.



KUSHTE PUNE FLEKSIBËL



Kodi i punës rregullon telepunën dhe punën nga shtëpia. Përgjatë telepunës/punës nga shtëpia punëmarrësi kryen punën në shtëpi, ose në një vend tjetër, të përcaktuar në marrëveshje me punëdhënësin, duke përdorur teknologjinë e informacionit, sipas kushteve të rëna dakord midis tyre.

